



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:073316

Datë: 22.11.2019

Numri i dokumentit: 00668330

P.nr.30/2019

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP.II.nr.3211-5/18 të datës 09.01.2019, ndaj të pandehurve L. S. dhe Q. S. qe te dy nga fshati S. Komuna Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndimi i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit te PTH-së nga Prizreni Shpend Binaj dhe te akuzuarve, në seancën e shqyrtimit fillestar, te mbajtur me dt.18.11.2019 mori, publikisht shpalli dhe me date 22.11.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **L. S.** i lindur më, i biri i M. S. dhe nënës K. S. K., e gjinisë me vendbanim në fshatin, S komuna Suharekë i gjendjes së mesme ekonomike beqar ka te kryer shkollën fillore, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës. me numër personal,
2. I akuzuari **Q. S.** i lindur më, i biri i M. S. dhe nënës K. S. K., e gjinisë, me vendbanim në fshatin, S komuna Suharekë i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, ka te kryer shkollën fillore, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës, me numër personal,

JANE FAJTOR

Sepse me dt. 06.12.2018 rreth orës 18:30 minuta, te akuzuarit ne rrugën Xhavit S. me saktësisht ne afërsi te lokalit "Ora Bar" ne bashkëpunim dhe koordinim ne mes veti pasi qe fillimisht u fjalosen me te dëmtuarin B. Th. për shkak te disa mosmarrëveshjeve te mëhershme lidhur me një borgje për bastore, te akuzuarit e sulmojnë me grushte neper pjesë te ndryshme te trupit, duke i shkaktuar lëndime te lehta trupore, lëndime këto te përshkruara me për afërsisht si ne akt ekspertimin e mjeko-ligjor te ekspertit Dr. F. I. H. me numër te ret 14/2018 te dt.30.122018.

- Me këtë ne bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par. 1 nenpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 45, 73, 74 KP , nenit 359 par. 1 dhe 2 dhe nenit 365 të par KPP-së, i u shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **L. S.**, duke ia caktuar dënimin me burgim prej dy (2) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne afatin e verifikimit prej dy viteve, nëse i akuzuarin nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit **Q. S.**, duke ia caktuar dënimin me burgim prej dy (2) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse ne afatin e verifikimit prej dy viteve, nëse i akuzuarin nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen te akuzuarit qe ne emër te shpenzimeve te ekspertizës mjeko-ligjore ta paguajnë shumën prej 20 €, në mënyrë solidarë, ne emër te kompensimit te viktimave te krimit te shumen prej 30 €, se cili veç e veç, si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej 20 €, se cili veç e veç, te gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B. Th. nga Suhareka, udhëzohet qe kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj ne kontest te regullt civil.

A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën PP.II.nr.3211-5/18 të datës 09.01.2019, ndaj të pandehurve L. S. dhe Q. S. qe te dy nga fshati S. Komuna Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar PSH ne Prizren Shpend Binaj, i cili në tersi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarve ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarve të cilët ne shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së, ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarve, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarve nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestar nga ana e te akuzuarve, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP, nga se nuk ekziston ndonjë nga aresyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarit janë fajtor dhe iu shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-së, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se të akuzuarit kanë pasur Q. korrekt ndaj Gjykatës, kanë pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, dukë u penduar dhe zotuar se ne te ardhmen vepra te tilla ose te ngjashme nuk do te përsërisin, janë të moshës së re, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par. 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate